



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC

KËSHILLI

Nr. 3483/14 Prot.

Pogradec, më 29.09.2025

VENDIM

NR. 94, DATË 25.09.2025

**“PËR MIRATIMIN PËR STREHIM TË PËRKOHSHËM SË ZNJ. ELVIRA ROVI  
NË BANESËN SOCIALE NË PRONËSI TË BASHKISË POGRADEC”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 1 dhe 2, nenit 9 pika 1.1/b, nenit 24, pikat 1 dhe 2, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit 139/2015“ Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 13 pika 1 gërma “b/iv”, nenit 15 pika 1.1/1, dhe pika 5, neni 16 gërma “a/v”, nenit 19 të ligjit, neni 30, shkronjës “dh”, të nenit 72 të ligjit nr. 22/2018“Për strehimin social” të ndryshuar, në VKB nr.63 datë 29.05.2024 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve nga programi i strehimit social “Subvencionimit të Qirasë” në VKM nr.384 datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim social sipas cdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore” në VKM nr. 301 datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet e strehimit social, me miratimin e Komisionit të Strehimit dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

1. Miratimin për strehim të përkohshëm për Znj. Elvira Rovi në Banesën Sociale në pronësi të Bashkisë Pogradec, konkretisht në njësinë me numër pasurie 397/228+1-20, Zona Kadastrale 1298 dhe me sipërfaqe 76.4m<sup>2</sup>, Adresa e apartamentit Rruga: Buçimas, Pogradec.
2. Kohëzgjatja e strehimit në banesën sociale në pronësi të Bashkisë Pogradec e përcaktuar në epikën 1, do të jetë për një periudhë 1 (një) vjeçare, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.



3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni i Strehimit, si dhe Drejtoria e Emergjencave, Strehimit dhe Administrimi i Tokës Bujqësore në Njësitë Administrative, Shërbimet dhe Titujt e pronësisë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

#### KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI



1. Miratuar me 19 vota

2. Vota Pro 19

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 25.09.2025